



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

DREJTORIA LIGJORE

SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 22.04.2026

PROCESVERBAL

Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje uniforma për Policinë Bashkiake”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Uniforma policie 35811200-4.

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,805,830 (*gjashtë milion e tetëqind e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë*) Lek pa TVSH.

Argumentim:

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS
LIMIT TË KONTRATËS**

Në zbatim të urdhrat të grupit të specifikimeve nr.119 e nr. 4496 prot., datë 02.04.2026 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Specifikimeve Teknike si dhe Përllogaritjen e Fondit Limit, për procedurën e prokurimit me objekt: *“Blerje uniforma për Policinë Bashkiake”*, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve për vitin 2026-2028.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit nëpërmjet:

1. Dokumenteve sipas buxhetit të Bashkisë të vitit 2026 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit
2. Shqyrtori dokumentat e mësipërme dhe programi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të hartuara nga grupi i specifikimeve teknike.

“Në Përllogaritjen e Vlerës Limit të Kontratës, Autoriteti Kontraktor ka marrë parasysh; Çmimet e botuara nga INSTAT- i ose/dhe çmime të tjera zyrtare të njohura nga institucionet përkatëse si psh., nga Organet Tatimore apo Doganore, Dhoma e Tregtisë, në Manuale etj, ose /dhe çmimet e Tregut; ose/ dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga Autoritete të Tjera Kontraktore dhe /ose çmime ndërkombëtare të publikuara.

1. Listat e publikuara nga INSTAT, nuk përmbajnë të dhëna mbi çmimet e mallrave që kërkohen të prokurohen.
2. Institucione të tjera zyrtare të njohura, u mor informacion lidhur me çfarë kërkohet.
3. Grupi u mbështet në çmimet orientuese në treg konkretisht në tre subjekte (të dhënat e çmimeve ndodhen të administruara në dosje) dhe çmimet e mëparshme për të gjithë elementet e kostos së mallrave objekt i këtij prokurimi.

Pas shqyrtimit të të dhënave dhe informacionit të mbledhur, mbështetur në rezultatin e sipërnxjerrë dhe metodologjinë e paracaktuar, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 6,805,830 (gjashtë milion e tetëqind e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë) Lek pa TVSH.

Garancia e mallit do të jetë sipas specifikimeve teknike, bashkëngjitur.

Afatet e lëvrimit: 30 (tridhjetë) ditë, nga nënshkrimi i kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas*

parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit të Shtojcës 8. (Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 pika 2, germa c) e 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...” duke qenë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës. dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se

“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë”. Kërkesa është në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2026 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Ky dokument duhet të dorëzohet në sistem gjatë fazës së ofertimit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2026 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

2.2 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 germa b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar me cilësi kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si vërtetime/fatura tatimore, të deklaruara në organet tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej jo më pak se 4 (katër) punonjës. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik për të asistuar stafin e AK gjatë procesit të prodhimit/ qepjeve/ përmasave apo modifikimeve për realizimin e uniformës së punonjësit të policisë bashkiake, duhet të ketë në stafin e tij, jo më pak se 4 (katër) punonjës për muajin e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit, të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore mbi numrin e punonjësve;

Ky kriter përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST si dhe në zbatim të përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentim: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori, duhet të ketë në zotërim certifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ku të jetë i përcaktuar objekti i prokurimit (e përkthyer e noterizuar). Certifikata duhet të jetë e vlefshme (ose ekuivalente) dhe e lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

ISO 9001 përfaqëson një standard kombëtar/ndërkombëtar unanim i njohur si standardi që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese. Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarde të cilësi.

- Certifikatë ISO 9001:2015- certifikatë e menaxhimit të cilësisë së mallrave, që kanë lidhje me objektin e kontratës.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, pika 1/a), nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standardeve ISO, është menduar së ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në proporcion me to, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Certifikata për sistemin e menaxhimit ISO 9001 është e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të vërtetuar dhe garantuar realizimin në kohë dhe me sukses të cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.*

2.4.2 Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë OEKO-TEX për tekstilet (ose ekuivalente me to), (standardi 100, kategoria II) të vlefshme, të prodhuesit të lëndës së parë. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, certifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit. Për këtë OE pjesëmarrës duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi i lëndës së parë ku të bëhet lidhja midis prodhuesit dhe OE/distributorit të autorizuar.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021*

”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Çertifikata Oeko-Tex, Standard 100, është standardi që përfshin artikujt që kanë kontakt direkt me lëkurën . Ky standard certifikon produktet pasi janë të testuara për substanca të dëmshme për të mbrojtur shëndetin e njeriut (kimikate toksike). Çdo komponent i një produkti, që nga lënda e parë (metrazhi) e deri te aksesorët , duhet të jetë testuar rigorozisht kundër shume kimikateve toksike. Qëllimi i certifikatës së tekstilit natyror është një praktikë miqësore me mjedisin dhe me përgjegjësi shoqërore që siguron një prodhim të qëndrueshëm, përfshirë etiketimin nga faza e prodhimit e deri ne zinxhirin përfundimtar të furnizimit, ndërsa konsideron sigurinë e produktit tek përdoruesi përfundimtar.

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë burimin e furnizimit për artikujt objekt prokurimi, duke specifikuar nëse është prodhues, distributor i autorizuar apo furnizohet nëpërmjet palëve te treta. Ne rast se operatori ekonomik nuk është prodhues, ai duhet te paraqesë dokumentacion qe provon mundësinë dhe ligjshmërinë e furnizimit te mallrave, përfshire autorizimin nga prodhuesi/distributori ose kontrate furnizimi me subjektet përkatëse, si dhe dokumentacion që vërteton lidhjen ndërmjet palëve. Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë te dhëna të mjaftueshme identifikuese por subjektin lëshues (*adresën e saktë të subjektit qe e ka lëshuar këtë dokument, adresën e postës elektronike, emrin, funksionin e zyrtarit nënshkrues, vulën e subjektit*), me qëllim verifikimin nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe ne nenin 40, pika 8, të VKM–së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Kjo kerkese është përcaktuar me qëllim që të sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara në dokumentat e tenderit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratës. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, si dhe përfshirjen dhe suportine prodhuesit, përmes vet atij apo distributorit të autorizuar, apo furnizohet nëpërmjet palëve te treta*

2.4.4 OE ofertues duhet të paraqesë certifikate konformiteti produkti për artikujt: Xhup, sipas standardeve SSH/ EN ISO 20471:2013; SSH/ EN 343:2019; SSH/ EN 342:2017; dhe Pelerinë shiu sipas standardeve SSH/ EN 343:2019 Klasi 3:1, në mënyrë që të vërtetohet cilësia e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në DT.

Argumentimi: Neni 44 pika 1,2,3,4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, i cili parashikon se autoriteti kontraktor mund të kërkojë prova që vërtetojnë përputhshmërinë e mallrave me standardet e kërkuara teknike. Këto certifikata lidhen drejtpërdrejt me natyrën dhe funksionin e mallrave që prokurohen, pasi artikujt e veshjes për Policinë Bashkiake duhet të garantojnë siguri, dukshmëri të lartë dhe mbrojtje ndaj kushteve atmosferike, në përputhje me standardet ndërkombëtare përkatëse. Standardi SSH/EN ISO 20471:2013 garanton dukshmërinë e lartë në kushte rreziku, SSH/EN 343:2019 përcakton mbrojtjen ndaj shiut dhe lagështirës, ndërsa SSH/EN 342:2017 lidhet me mbrojtjen ndaj temperaturave të ulëta. Për rrjedhojë, kërkesa për paraqitjen e këtyre certifikatave është proporcionale, e justifikuar dhe e nevojshme për të siguruar që produktet e ofertuara përmbushin standardet minimale të cilësisë dhe sigurisë, duke garantuar realizimin korrekt të kontratës dhe mbrojtjen e interesit publik.

2.4.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Raport Testimi (fletë-analizë) për artikullin: “I.Kostum uniforme, përkatësisht për artikullin: Xhakëtë ngjyrë blu të errët; Pantallona ngjyrë blu të errët; Bluzë me mëngë të gjata blu e errët, të lëshuar nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe synon të verifikojë në mënyrë të besueshme përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të kërkuara. Përmes testimeve zyrtare nga laboratorë të akredituar garantohej cilësia, qëndrueshmëria dhe performanca e materialeve, të cilat janë thelbësore për uniformat e Policisë Bashkiake, duke ndikuar drejtpërdrejt në sigurinë, komoditetin dhe kushtet e punës së përdoruesve. Për rrjedhojë, kërkesa është proporcionale dhe e nevojshme për të siguruar furnizimin me produkte cilësore, në përputhje me standardet teknike dhe interesin publik.

2.4.6 Operatori ekonomik në lidhje me artikujt e veshjeve objekt prokurimi duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet të lëshuara nga një organ i akredituar.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar
1			
Etj.,			

Argumentim: Në bazë të pikës 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

ilustrojnë mjetet e ofruara prej tyre dhe te vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me te gjitha specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim.

II Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në specifikimet teknike të hartuara nga struktura e posaçme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor konstatohet se plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 40 pika 2 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në këto kushte njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT,

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit